REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 688 Nr. i faq/Br.str/No.pg 161
Data/Datum/Date 5 / 6 /
...HOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna e Rahovecit***

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

LISTA E VENDIMEVE TE MARRURA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

**MUAJI MAJ 2023**

| Nr | Emri i vendimit | Nr. Protokollit |
|---|---|---|
| 1 | Vendim-miratohet kërkesa e z. [redacted] | NRP-02-525-2023 |
| 2 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin | NRP-02-527-2023 |
| 3 | Vendim për qasje në dokumente publike | NRP-02-528-2023 |
| 4 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyërsit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-534-2023 |
| 5 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyërsit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-535-2023 |
| 6 | Vendim për ndërprejrjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull''Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovevit | NRP-02-536-2023 |
| 7 | Vendim për ndërprejrjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull''Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovevit | NRP-02-537-2023 |
| 8 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-538-2023 |
| 9 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyërsit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-539-2023 |
| 10 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-543-2023 |
| 11 | Vendim për caktimin e komisionit për rivlerësimin e ofertave | NRP-02-545-2023 |
| 12 | Vendim për qasje në dokumente publike | NRP-02-546-2023 |
| 13 | Vendim për caktimin e komisionit për pranimin e shërbimeve | NRP-02-551-2023 |
| 14 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyërsit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-552-2023 |
| 15 | Vendim për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontraten me titull ''Rregullimi i varrezave të dëshmoreve dhe civilëve - Lot 1'' | NRP-02-558-2023 |
| 16 | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. Prot. 02/417/2023, i datës 6.4.2023 | NRP-02-560-2023 |
| 17 | Vendim - miratohet kërkesa e z[redacted] | NRP-02-561-2023 |
| 18 | Vendim për qasje në dokumente publike-INPO | NRP-02-562-2023 |
| 19 | Vendim për ndërprejrjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull''Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovevit'' | NRP-02-563-2023 |
| 20 | Vendim për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punëve në terren, për ygjedhjen e Këshillave lokal në fshatra dhe në lagjet urbane në Komunën e Rahovecit | NRP-02-566-2023 |
| 21 | Vendim - miratohet kërkesa e z[redacted] | NRP-02-571-2023 |
| 22 | Vendim - miratohet kërkesa [redacted] | NRP-02-572-2023 |
| 23 | Vendim për për përfundimin e marrëdhënies së punës-Kujtim Popaj nga Fortesa | NRP-02-575-2023 |

| | | |
|---|---|---|
| 24 | Vendim per caktimin e komisionit per vleresimin e ofertave | NRP-02-585-2023 |
| 25 | Vendim per caktimin e komisionit per vleresimin e ofertave | NRP-02-586-2023 |
| 26 | Vendim për qasje në dokumente publike | NRP-02-590-2023 |
| 27 | Vendim për qasje në dokumente publike-DPLUS | NRP-02-593-2023 |
| 28 | Vendim për formimin e komisionit për pajisje me vula, për nevojat e Komunës së Rahovecit | NRP-02-594-2023 |
| 29 | Vendim-miratohet kë[redacted] | NRP-02-595-2023 |
| 30 | Vendim per caktimin e komisionit per vleresimin e dëmeve | NRP-02-596-2023 |
| 31 | Vendim për caktimin e Këshillit Organizues për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës | NRP-02-598-2023 |
| 32 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-609-2023 |
| 33 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-610-2023 |
| 34 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-621-2023 |
| 35 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-630-2023 |
| 36 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-631-2023 |
| 37 | Vendim për caktimin e komisionit për rivlerësimin e ofertave | NRP-02-632-2023 |
| 38 | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-634-2023 |
| 39 | Vendim për qasje në dokumente publike | NRP-02-635-2023 |
| 40 | Vendim për lejimin e udhëtimit zyrtar | NRP-02-641-2023 |
| 41 | Vendim për lejimin e udhëtimit zyrtar | NRP-02-642-2023 |
| 42 | Vendim miratohet kërkesa e [redacted] | NRP-02-644-2023 |
| 43 | Vendim miratohet kërkesa e[redacted] | NRP-02-646-2023 |
| 44 | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt | NRP-02-648-2023 |
| 45 | Vendim për caktimin e komisionit për pranimin e shërbimeve | NRP-02-656-2023 |
| 46 | Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës | NRP-02-657-2023 |
| 47 | Vendim-miratohet [redacted] | NRP-02-658-2023 |

**Rahovec, maj 2023**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 525 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1/6
Data/Datum/Date 2/5/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [redacted], Komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolli 311, të datës 30.1.2023 për ndihmë financiare prej 900.00€ (nëntëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve te mjekimit dhe [redacted]

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/193/23, i datës 21.2.2023.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

[redacted] e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. [redacted] për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërim kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 527 Nr. i faq/Br.str/No.pg 146
Data/Datum/Date 2 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")* dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmit të shkaktuar në kulturën e grurit, sipas kërkesës me Nr. Prot. 1598 të datës 25.4.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Hasan Vuqitërna, kryesues,
    **1.2.** Ilvi Durguti, anëtar,
    **1.3.** Veton Mustafa, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e dëmit të shkaktuar në kulturën e grurit, duke u bazuar në kërkesën me Nr. Prot. 1598, të datës: 25.4.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë: 12.5.2023.

5. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***DBPZHR-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 528 Nr. i faq/Br.str/No pg 1h6
Data/Datum/Date 2 / 5 / 23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
## Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/522/23, e datës 28.4.2023 për qasje në dokumente publike nga OJQ "Demokraci Plus (D+)" dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë:
   **1.1.** Kontrata me titull: "LOT 3 – Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Faza e dytë" me nr. prokurimi 623-21-4731-5-1-1;
   **1.2.** Kontrata me titull: "Asfaltimi i rrugës Fortesë – Hamoc – Rahovec, me nr. prokurimi 623-19-3572-5-1-1; dhe
   **1.3.** Kontrata me titull: "Trajtimi i shtretërve të përrenjve në Komunën e Rahovecit – LOT III Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq".

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### *A r s y e t i m*

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/522/23, e datës 28.4.2023 për qasje në dokumente publike nga OJQ "Demokraci Plus (D+)", për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtës i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në Kontrata me titull: "LOT 3 – Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit - Faza e dytë" me nr. prokurimi 623-21-4731-5-1-1; Kontrata me titull: "Asfaltimi i rrugës Fortesë – Hamoc – Rahovec me nr. prokurimi 623-19-3572-5-1-1 dhe Kontrata me titull: "Trajtimi i shtretërve të përrenjve në Komunën e Rahovecit – LOT III Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq".

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

*Vendimi u dërgohet:*

- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,***
- ***OJQ "Demokraci Plus (D+)", dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPSTINE
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Lot 1 – Sistemi për menaxhimin e radhës" me numër të kontratës 623-23-1171-1-2-1/C471, si në vijim:

   1.1. Z. Dritan Sokoli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për teknologji informative, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2. Z. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Administratë, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 534 Nr. i faq/Br.str/No pg 147
Data/Datum/Date 3 . 5 . 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me karrige stomatologjike", me numër të kontratës 623-23-1107-1-2-1/C473, si në vijim:

   1.1. Z. Qazim Cana, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Koordinator i cilësisë në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Znj. Saranda Sallteku, Drejtore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***DSHPS-ja, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 535 Nr. i faq/Br.str/No.pg 147
Data/Datum/Date 3 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 536 Nr. i faq/Br.str/No.pg 147
Data/Datum/Date 3 / 5 / 23
RAHOVEC-ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022, për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 1661, të datës 2.5.2023, për ndërprerjen e kontratës me titullin: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C387, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"**

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C387, me Nr. Prot.2360, e datës 4.7.2022.

2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Z. Shpetim Dulaku nga fshati Opterushë, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë te Menaxheri i Kontratës me Nr. Prot 1064, të datës 20.3.2023 për dorëheqje dhe ndërprerjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C387 dhe me Nr. Prot. 2360, e datës 4.7.2022, i cili ishte i angazhuar si Konsulent individual për Inovacione në Rini, Kulturë dhe Sport, nga data 4.7.2022.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës me kërkesën me Nr. Prot. 1661, të datës 2.5.2023, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrtarin Kryesor Administrativ për ndërprerjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C387 dhe me Nr. Prot.2360, e datës 04.07.2022, në të cilën z. Shpetim Dulaku, ishte i angazhuar si Konsulent individual për Inovacione në Rini, Kulturë dhe Sport.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushtet e Përgjithshme të Kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C387, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, janë

përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate me kërkesë të Ofruesit të Shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 2360, e datës 4.7.2022, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C387.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Z. Shpetim Dulaku,***
- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPSTINE / MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS/PRESEDNIK OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 537 Nr. i feq/Br.str/No.pg 147
Data/Datum/Date 3 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC


Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik, me Nr. Prot. 82/2022, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 1662, të datës 2.5.2023 për ndërprerjen e kontratës me titullin: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C377, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**

**Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"**

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C377, me Nr. Prot.2350, e datës 4.7.2022.

2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Znj. Qendresë Kryeziu nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë te Menaxheri i Kontratës, me Nr. Prot. 1649, të datës 2.5.2023 për ndërprerjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit" me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C377 dhe me Nr. Prot. 2350, e datës 4.7.2022, e cila ishte e angazhuar si Konsulente individuale për buxhet dhe financa në Rahovec, nga data 4.7.2022.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës, me kërkesën me Nr. Prot. 1662, të datës 2.5.2023, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrtarin Kryesor Administrativ për ndërprerjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C377 dhe me Nr. Prot.2350, e datës 4.7.2022, në të cilën znj. Qendresë Kryeziu ishte e angazhuar si Konsulente individuale për buxhet dhe financa në Rahovec.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushtet e Përgjithshme të Kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C377, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, janë

përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate me kërkesë të Ofruesit të Shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 2350, e datës 4.7.2022, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C377.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Znj. Qendresë Kryeziu,***
- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 538 Nr. i faq/Br.str/No.pg 147
Data/Datum/Date 3/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-4073-5-2-5 dhe Nr. të brendshëm 623-21-4547-5-1-1/5, të datës: 3.4.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Faik Thaqi, kryesues,
    **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
    **1.3.** Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec", me Nr. prokurimi: 623-23-4073-5-2-5 dhe Nr. të brendshëm 623-21-4547-5-1-1/5, të datës: 3.4.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 539 Nr. i faq/Br.str/No.pg 147
Data/Datum/Date 2/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Furnizim me material higjieniko - sanitar", me numër të kontratës 623-23-1564-1-2-1/C474, si në vijim:

   1.1. Z. Qamil Sylka, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Depoist, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2. Z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 543 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 148
Data/Datum/Date 4/5/23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Riparimi i objekteve të gjendjes civile", me Nr. prokurimi: 623-23-3454-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-039-5-2-1, të datës: 3.5.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jetmir Ukaj, kryesues,
   **1.2.** Kosovare Gashi, anëtare,
   **1.3.** Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Riparimi i objekteve të gjendjes civile", me Nr. prokurimi: 623-23-3454-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-039-5-2-1, të datës: 3.5.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 545 Nr. i faq/Br.str/No.pg 148
Data/Datum/Date 4 / 5 / 23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për rivlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për rivlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizime mjekësore për nevojat e QKMF-së, Lot 1 – Blerja e EKG-së për nevojat e QKMF-së", me Nr. prokurimi: 623-22-11331-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-22-054-1-2-1, në këtë përbërje:

   **1.1.** Egzon Thaqi, kryesues,
   **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
   **1.3.** Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë rivlerësimin e ofertave për projektin "Furnizime mjekësore për nevojat e QKMF-së, Lot 1 – Blerja e EKG-së për nevojat e QKMF-së", me Nr. prokurimi: 623-22-11331-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-22-054-1-2-1.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar I Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 546 Nr. i faq/Br.str/No.pg 148
Data/Datum/Date 5 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës se Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/540/23, e datës 3.5.2023 për qasje në dokumente publike e Viona Bunjaku nga Lëvizja FOL dhe i ofrohet qasje e **plotë** në tenderin (kontratën) me Nr. Prokurimi 623-22-2161-2-2-1, dhe atë:
   **1.1.** Raporti i vlerësimit;
   **1.2.** Vendimi për themelimin e komisionit të vlerësimit;
   **1.3.** Oferta e fituesit të kontratës;
   **1.4.** Faturat dhe pagesat; dhe
   **1.5.** Dokumentet që tregojnë analizën e tregut.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/540/23, e datës 3.5.2023 për qasje në dokumente publike nga Viona Bunjaku nga Lëvizja FOL, për qasje në dokumente publike.
Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtës i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në kontratën me Nr. Prokurimi 623-22-2161-2-2-1 dhe atë: Raporti i vlerësimit; Vendimi për themelimin e komisionit të vlerësimit; Oferta e fituesit të kontratës; Faturat dhe pagesat dhe Dokumentet që tregojnë analizën e tregut.
Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.
Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,***
- ***Viona Bunjakut nga Lëvizja FOL, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF K
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY R.
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNIC
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të K...
Nr./Br./No 551 Nr. i faq/Br.str/No.pg 149
Data/Datum/Date 5 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2018")*, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 te Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për pranimin e shërbimeve**

1. **Caktohet** komisioni për pranimin e shërbimeve sipas kontratës: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues: 623-23-723-2-2-1/C462, në këtë përbërje:
   - **1.1.** Ardian Rama, kryesues
   - **1.2.** Petrit Haxhijaha, anëtar
   - **1.3.** Luan Sharku, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë pranimin e shërbimeve sipas kontratës "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues: 623-23-723-2-2-1/C462.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Drejtorinë për Administratë dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit dhe Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria për Administratë.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Administratë,***
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njesia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 552 Nr. i faq/Br.str/No.pg 149
Data/Datum/Date 5 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Lot 2 – Digital Sender dhe pjesë të teknologjisë informative" me numër të kontratës 623-23-1171-1-2-1/C472, si në vijim:

   **1.1** z. Dritan Sokoli i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për teknologji informative, pranë Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2** z. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyersi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtorisë për Administratë, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 558 Nr. i faq/Br.str/No.pg 149
Data/Datum/Date 8 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull "Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot 1" me Nr. të Prokurimit 623-20-3325-5-2-1, Kërkesës së Menaxherit të kontratës me Nr. Prot. 1686 të datës 4.5.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

**Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull "Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot 1"**

1. Me këtë vendim **lejohet** ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot 1" me Nr. të Prokurimit 623-20-3325-5-2-1.

2. Ndërrimi i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicionet e kontratës: Punët e mermerit dhe granitit nr. 1 dhe 2 dhe Punët e kubzave të betonit nr. 1 dhe 2, në pozicionet e domosdoshme për realizim: Punët e zhavorrit nr. 1, 2, 3 dhe 4; Punët e betonit nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9; dhe Punët e gurëve nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 pa implikime shtesë financiare.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtëpërdrejtë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull "Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot 1" me Nr. të Prokurimit 623-20-3325-5-2-1, me datë 10.02.2023 i ka rekomanduar menaxherit të kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të përfundimit të këtij projekti.

Pas kësaj, Menaxheri i Kontratës, përmes Mbikëqyrisit të drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot. 1686 të datës 4.5.2023, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot 1" me Nr. të Prokurimit 623-20-3325-5-2-1 dhe atë nga pozicionet e kontratës: Punët e mermerit dhe granitit nr. 1 dhe 2 dhe Punët e kubzave të betonit nr. 1 dhe 2, në pozicionet e domosdoshme për realizim: Punët e zhavorrit nr. 1, 2, 3 dhe 4; Punët e betonit

nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9; dhe Punët e gurëve nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 pa implikime shtesë financiare, pa implikime shtesë financiare.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të përfundimit të projektit, me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Menaxheri i Kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,***
- ***Njësisë së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
... TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 560 Nr. i faq/Br.str/No.pg 149
Data/Datum/Date 8/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53, paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, paragrafi 2, pika 2.1 dhe 2.2, i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

# VENDIM

## Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr. Prot. 02/417/22, i datës 6.4.2023

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/417/22, i datës 6.4.2023 për ndihmë financiare prej 1,000.00€ (njëmijë euro), për mbulimin e shpenzimeve te mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes, për z. Osman Zyberaj nga fshati Drenoc, komuna e Rahovecit.

2. Pika **2** e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

   2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe do të derdhen në xhirollogari të Adelina Zyberaj Krasniqi, Nr. 1502031002516948 në Raiffeisen Bank.

3. Pikat e tjera të vendimit bazik, me Nr. Prot. 02/417/22, i datës 6.4.2023, mbesin të pandryshuara.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Osman Zyberaj nga fshati Drenoc,***
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0018590/23, e dt. 28.04.2023 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katerqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

[redacted] nga Rahoveci me datë 28.04.2023 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 17.04.2023 ka lindur vajzë në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted], si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 561 Nr. i faq/Br.str/No.pg 150
Data/Datum/Date 8 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 562 Nr. i faq/Br.str/No.pg 150
Data/Datum/Date 10/5/23
RAHOVEC/ORAHOVAC


Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
## Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/542/23, e datës 3.5.2023, për qasje në dokumente publike, e Lorenta Alija, nga OJQ "Iniciativa për Progres – INPO" dhe i ofrohet qasje e **plotë** në kontratën me titull "Pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së", me Nr. të prokurimit 623-23-1282-1-2-1.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### *A r s y e t i m*

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/542/23, e datës 3.5.2023, për qasje në dokumente publike, nga Lorenta Alija, nga OJQ "Iniciativa për Progres – INPO", për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, Lorenta Alijajt, i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në kontratën me titull "Pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së" me Nr. të prokurimit 623-23-1282-1-2-1.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,***
- ***Lorenta Alijat, nga OJQ "Iniciativa për Progres – INPO", dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 563 Nr. i faq/Br.str/No.pg 150
Data/Datum/Date 10 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, nenit 72 të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik me Nr. Prot. 82/2022, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kërkesës dhe rekomandimit të Menaxherit të Projektit me Nr. Prot. 1732, të datës 8.5.2023 për ndërprerjen e kontratës me titullin: "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C390, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit"**

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit për ndërprerjen e kontratës me marrëveshje të dyanshme me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C390, me Nr. Prot. 2363, e datës 4.7.2022.

2. **Obligohet** Zyra e Prokurimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Liridonë Thaqi, nga Dobidoli, Komuna e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë te Menaxheri i Kontratës, me Nr. Prot. 1689, të datës 4.5.2023, për ndërprerjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C390 dhe me Nr. Prot. 2363, e datës 4.7.2022, e cila ishte e angazhuar si Konsulente individuale për trajtimin e rasteve me nevoja të veçanta për Arsim, nga data 4.7.2022.

Pas kësaj, Menaxheri i kontratës, me kërkesën me Nr. Prot. 1732, të datës 8.5.2023, ka kërkuar dhe njëherit ka rekomanduar Zyrtarin Kryesor Administrativ për ndërprerjen e kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C390 dhe me Nr. Prot. 2363, e datës 4.7.2022, në të cilën, Liridonë Thaqi, ishte e angazhuar si Konsulente individuale për trajtimin e rasteve me nevoja të veçanta për Arsim.

Duke u bazuar në nenin 10 të Kushtet e Përgjithshme të Kontratës me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C390, si dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, janë

përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kësaj kontrate me kërkesë të Ofruesit të Shërbimeve.

Pas administrimit të të gjitha provave, Kryetari i Komunës, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen e kontratës me Nr. Prot. 2363, e datës 4.7.2022, me titull "Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. identifikues 623-22-5173-2-1-1/C390.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Liridonë Thaqi, nga Dobidoli,***
- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Menaxheri i Projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të projektit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, dispozitave të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, Statutit të Komunës, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01, Nr..278, të datës 28.2.2022, për formimin e Komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punëve në terren për zgjedhjen e Këshillave lokale në fshatra dhe në lagjet urbane, në Komunën e Rahovecit, Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 597, të datës 16.2.2018 për pagesën e mëditjeve të të gjithë anëtarëve të të gjitha Komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr.1090, të datës 29.3.2018, për plotësim - ndryshim të vendimit 01 Nr. 597, të datës 16.2.2018, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të Komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punëve në terren, për zgjedhjen e Këshillave lokale në fshatra dhe në lagjet urbane në Komunën e Rahovecit**

1. Me këtë vendim, **lejohet** pagesa e mëditjeve për anëtarët e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punëve në terren për zgjedhjen e Këshillave lokale në fshatra dhe në lagjet urbane në Komunën e Rahovecit, të formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 278, të datës 28.2.2022, si në vijim:
   - 1.1. Melinda Iska: **20 x 30€ = 600 € ( gjashtëqind euro);**
   - 1.2. Faton Ramadani: **20 x 30€ = 600 € ( gjashtëqind euro);**
   - 1.3. Nora Boshnjaku: **20 x 30€ = 600 € ( gjashtëqind euro);**
   - 1.4. Afrim Berisha: **20 x 30€ = 600 € ( gjashtëqind euro);**
   - 1.5. Leonard Morina: **20 x 30€ = 600 € ( gjashtëqind euro);**
   - 1.6. Vjollca Gurgule: **14 x 30€ = 420 € ( katërqind e njëzet euro);**
   - 1.7. Agim Hoti: **4 x 30 = 120 € ( njëqind e njëzet euro ).**

2. Të lartpërmendurve në pikën 1 të këtij vendimi, u lejohet pagesa e mëditjeve, pasi kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura me qytetarët e komunës së Rahovecit për zgjedhjen e Këshillave lokale në fshatra dhe në lagjet urbane në komunën e Rahovecit.
3. Të lartpërmendurit kanë të drejtë kompensimi, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr.597, të datës 16.2.2018, për pagesën e mëditjeve të të gjithë anëtarëve të të gjitha komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr.1090, të datës 29.3.2018, për plotësim - ndryshim të vendimit 01 Nr. 597, të datës 16.2.2018.
4. Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi buxhetor Paga dhe Mëditje.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Shtojcë e këtij vendimi është lista nënshkruese dhe Raporti i anëtarëve të komisionit, të cilët kanë marrë pjesë në takimet me qytetarët.
7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Të lartpërmendurve në pikën 1,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 566 Nr. i faq/Br.str/No.pg 150
Data/Datum/Date 10/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008 ), nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, dhe neneve 74 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] - Komuna e Rahovecit, me Nr.1576, të datës 20.4.2023, për përkrahjen financiare në vlerë prej **150.00 € ( njëqind e pesëdhjetë euro)** për mbulimin e shpenzimeve për pjesmarje në samitin ndërkombëtar "LEAP SUMMIT", i cili do të mbahet nga **17 – 19 maj 2023,** në Zagreb të Republikës së Kroacisë.

2. Mjetet do të sigurohen nga Kodi i subvencioneve të zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

***U dërgohet:***

- [redacted]
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 571 Nr. i faq/Br str/No pg 151
Data/Datum/Date 11/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ( Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008 ), nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, dhe neneve 74 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** [redacted], me Nr.1751, të datës 10.5.2023, për përkrahjen financiare në vlerë prej **150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro)** për mbulimin e shpenzimeve për pjesmarjen në samitin ndërkombëtar "LEAP SUMMIT", i cili do të mbahet nga **17 – 19 maj 2023,** në Zagreb të Republikës së Kroacisë.

2. Mjetet do të sigurohen nga Kodi i subvencioneve të zyrës së Kryetarit të Komunës.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

***U dërgohet:***

- [redacted]
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 572 Nr. i faq/Br.str/No.pg 151
Data/Datum/Date 11 / 5 / 23
RAHOVEC/ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 575 Nr. i faq/Br.str/No.pg 151
Data/Datum/Date 11 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, si dhe nenit 92, të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **KUJTIM POPAJ** nga Fortesa, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Inxhinier në Zyrën e Prokurimit, në Zyrën e Kryetarit të Komunës, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 28.5.2023.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave, nga data 28.5.2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Punëtorit **KUJTIM POPAJ** nga Fortesa, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Inxhinier në Zyrën e Prokurimit, në Zyrën e Kryetarit të Komunës, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 28.5.2023.

Sipas detyrës zyrtare, Njësia e personelit ka konstatuar se punëtori i lartpërmendur, më 27.5.2023, arrin moshën e pensionimit, ngase i bën 65 vjet.

Prandaj, Kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit **KUJTIM POPAJ** nga data 28.05.2023, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga sa u tha më lart, Kryetari i Komunës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi punëtoria ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

**Kopja e vendimit u dorëzohet:**
1. Punëtorit,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
3. Dosjes personale, dhe
4. Arkivit.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 585 Nr. i faq/Br.str/No.pg 152
Data/Datum/Date 15/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në Stacionin e Autobusëve", me Nr. prokurimi: 623-23-3157-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-037-5-2-1, të datës 5.5.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Sokol Thaqi, kryesues,
   **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
   **1.3.** Faik Thaqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës në Stacionin e Autobusëve", me Nr. prokurimi: 623-23-3157-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-037-5-2-1, të datës 5.5.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS / RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 586 Nr. i faq/Br.str/No.pg 152
Data/Datum/Date 15/5/23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Renovime në shkolla", me Nr. prokurimi: 623-23-3431-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-036-5-2-1, të datës 10.5.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues,
   **1.2.** Egzon Thaqi, anëtar,
   **1.3.** Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Renovime në shkolla", me Nr. prokurimi: 623-23-3431-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-036-5-2-1, të datës 10.5.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 590 Nr. i faq/Br.str/No.pg 152
Data/Datum/Date 16 / 5 / 23
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/579/23, e datës 12.5.2023, për qasje në dokumente publike e Lorenta Alija, nga Iniciativa për progres INPO, dhe i ofrohet qasje e **plotë** në të gjitha kontratat e nënshkruara me Operatorin Ekonomik MADEKOS ndë rvite, duke përfshirë titullin e kontratës, numrin e kontratës dhe vlerën e saj.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/579/23, e datës 12.5.2023, për qasje në dokumente publike nga Lorenta Alija, nga Iniciativa për progres INPO, për qasje në dokumente publike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në të gjitha kontratat e nënshkruara me Operatorin Ekonomik MADEKOS ndër vite, duke përfshirë titullin e kontratës, numrin e kontratës dhe vlerën e saj.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,***
- ***Lorenta Alija nga Iniciativa për progres INPO, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/580/23, e datës 12.5.2023 për qasje në dokumente publike e Diell Haxhimusës dhe i ofrohet qasje e **plotë** në atë se nëse ka pasur ndryshime të menaxherëve të kontratave si në vijim:
   **1.1.** Kontrata me titull "LOT 3 – Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit – Faza e dytë", me nr. Prokurimi 623-21-4731-5-1-1;
   **1.2.** Kontrata me titull "Asfaltimi i rrugës Fortesë – Hamoc – Rahovec", me nr. Prokurimi 623-19-3572-5-1-1;
   **1.3.** Kontrata me titull "Trajtimi i shtretërve të përrenjve në Komunën e Rahovecit – LOT III Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq".

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Arsyetim***
Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/580/23, e datës 12.5.2023 për qasje në dokumente publike nga Diell Haxhimusa.
Pas shqyrtimit të kërkesës, i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë se nëse ka pasur ndryshime të menaxherëve të kontratave, si në vijim: Kontrata me titull "LOT 3 – Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit – Faza e dytë" me nr. Prokurimi 623-21-4731-5-1-1; Kontrata me titull "Asfaltimi i rrugës Fortesë – Hamoc – Rahovec" me nr. Prokurimi 623-19-3572-5-1-1 dhe Kontrata me titull "Trajtimi i shtretërve të përrenjve në Komunën e Rahovecit – LOT III Ndërtimi i kanalit të kullimit në fshatin Sapniq".
Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.
Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,***
- ***Diell Haxhimusës, dhe***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 593 Nr. i fq/Br.str/No.pg 153
Data/Datum/Date 16/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2018")*, dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
## Për formimin e komisionit për pajisje me vula, për nevojat e Komunës së Rahovecit

1. Me këtë vendim, formohet komisioni për pajisje me vula, për nevojat e Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
   - **1.1.** Mirsad Shala, kryesues,
   - **1.2.** Fjolla Duraku, anëtare,
   - **1.3.** Valmir Gashi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që t'i kryejë procedurat e marrjes së lejes për vula, porositjen e vulave te vulëpunuesi dhe veprime të tjera të parapara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-054 për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës.

3. Për nevojat e Komunës së Rahovecit do të kryhet furnizimi me 1 (një) vulë katrore për vendimet e ekzekutueshme dhe 1 (një) vulë katrore për vendimet e plotëfuqishme.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për Drejtorinë për Administratë dhe Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 594 Nr. i faq/Br.str/No.pg 153
Data/Datum/Date 16/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008 ), nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 21, të Rregullores për ndarjen e subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, dhe neneve 74 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted], me Nr.1524, të datës 14.4.2023, për mbështetje financiare në vlerë prej **300.00 € (treqind euro)** për mbulimin e shpenzimeve për barna dhe të terapisë së vazhdueshme.

2. Mjetet do të sigurohen nga Kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

***U dërgohet :***

- [redacted]
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 595 Nr. i faq/Br.str/No.pg 153
Data/Datum/Date 16 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")* dhe neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmit të shkaktuar në bujqësi, sipas kërkesës me Nr. Prot. 1752, të datës 10.5.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Veton Mustafa, kryesues,
    **1.2.** Hasan Vuqitërna, anëtar,
    **1.3.** Bekim Krasniqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë që të konstatojë dhe të bëjë vlerësimin e dëmit të shkaktuar në bujqësi, duke u bazuar në kërkesën me Nr. Prot. 1752, të datës 10.5.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri më datë 26.5.2023.

5. Komisioni do të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***DBPZHR-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi,**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
Njësia Nr./Br./No. 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 596 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 153
Data/Datum/Date 16/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 598 Nr.fq./Br.str/No.pg 153
Data/Datum/Date ... 23
RAHOVEC / ORA...

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 7, paragrafi 2, pika 2.1, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

**Për caktimin e Këshillit Organizues për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës**

1. Caktohet Këshilli Organizues për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
   1.1. Fatmir Iska, kryesues,
   1.2. Afrim Dina, anëtar,
   1.3. Defrim Kafexhiu, anëtar,
   1.4. Dervish Çadraku, anëtar,
   1.5. Feriz Thaqi – përfaqësues i OVL-UÇK-së, anëtar,
   1.6. Isuf Gashi, anëtar,
   1.7. Qemajl Krasniqi, anëtar,
   1.8. Fjolla Duraku, anëtare,
   1.9. Avni Morina, anëtar,
   1.10.Besmire Bytyqi, anëtare,
   1.11. Nora Boshnjaku, anëtare,
   1.12. Muharem Morina, anëtar,
   1.13. Saranda Sallteku, anëtare,
   1.14. Besnik Hoti, anëtar,
   1.15. Naser Dula, anëtar.

1. Këshilli ka për detyrë t'i ndërmarrë të gjitha veprimet organizative për shënimin e 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës, dhe shpërndarjen e ftesave për grupe dhe individë të rëndësishëm për pjesëmarrje, të bëjë ndarjen e mirënjohjeve, të bëjë rregullimin e vendit ku do të zhvillohen aktivitetet.

2. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative për shënimin e Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit, i takon Kryesuesit të Këshillit Organizues.

3. Këshilli Organizues është i obliguar që t'i raportojë Kryetarit të Komunës mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjithë anëtarët e Këshillit Organizues.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e Këshillit Organizues,***
- ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 609 Nr. i faq/Br.str/No.pg 154
Data/Datum/Date 19/ 5/ 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (*"Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"*), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Pajisja e shkollave me mjete konkretizuese dhe laboratorike", me numër të kontratës 623-23-2957-1-2-1/C480, si në vijim:

   1.1. Z. Admirim Durguti, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për paga dhe shpenzime, në Drejtorinë për Arsim, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2. Z. Avni Morina, Drejtor i Drejtorisë për Arsim, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 610 Nr. i faq/Br.str/No.pg 154
Data/Datum/Date 19/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18. i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Vendosja e tabelave për emërtim të rrugëve, parqeve dhe shesheve", me numër të kontratës 623-23-1686-5-2-1/C476, si në vijim:

   1.1. Z. Jetmir Ukaj, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar Teknik i Ndertimit në Drejtorinë e Administratës, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2. Z. Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***DUPMM-ja, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
__________
**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 621 Nr. i faq/Br.str/No.pg 155
Data/Datum/Date 23 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61, paragrafi 61.15. i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01, i datës 10.4.2019, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Ndërtimi dhe rregullimi i oborrit te Depot e Matrexit - Xërxë", me numër të kontratës 623-22-6025-5-2-1/C401, si në vijim:

   1.1. Z. Venhar Topalli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për shërbime publike, në Drejtorinë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2. Z. Erhan Morina, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3007/22, i datës 21.11.2022.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Menaxheri i projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr/Br./No 636 Nr. i faq/Br str/No.pg 156
Data/Datum/Date 25/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Furnizim me material administrativ, të cilat nuk janë të përfshira me kontratat e AQP-së", me numër të kontratës 623-23-2486-1-2-1/C482, si në vijim:

   1.1. Z. Petrit Haxhijaha, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar i Teknologjisë Informative, në Drejtorinë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Z. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Administratë, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 631 Nr. i faq/Br.str/No.pg 56
Data/Datum/Date 25/5/23

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme në institucione publike", me Nr. prokurimi: 623-23-2282-2-1-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-028-2-1-1, të datës: 23.5.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues,
   **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
   **1.3.** Meriton Gashi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme në institucione publike", me Nr. prokurimi: 623-23-2282-2-1-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-028-2-1-1, të datës: 23.5.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajil Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 632 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 25/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e komisionit për rivlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për rivlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-së", me Nr. prokurimi: 623-23-1684-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-021-1-2-1, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues,
   **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
   **1.3.** Meriton Gashi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë rivlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me inventar për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-së", me Nr. prokurimi: 623-23-1684-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-021-1-2-1.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 634 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 26 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i e-kioskut - Ritenderim", me Nr. prokurimi: 623-23-4333-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-026-5-2-1, të datës 24.5.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Egzon Thaqi, kryesues,
    **1.2.** Vjollca Berisha, anëtare,
    **1.3.** Mimoza Ejupi, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Ndërtimi i e-kioskut - Ritenderim", me Nr. prokurimi: 623-23-4333-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-026-5-2-1, të datës 24.5.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 635 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 26/5/23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Aprovohet pjesërisht** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/612/23, e datës 19.5.2023 për qasje në dokumente publike, nga z[redacted] sipas autorizimit dhe, i ofrohet qasje e **pjesshme** në dosjen e konkursit me nr. Prot. 04/752, i datës 8.2.2023, të shpallur nga Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Arsyetim***

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/612/23, e datës 19.5.2023 nga z. Arif Morina, sipas autorizimit për qasje në dokumente publike, dhe i ofrohet qasje **e pjesshme** në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Arsim, me Nr. Prot. 04/752, të datës 8.2.2023: Vendimin për emërimin e komisionit intervistues, me Nr. Prot. 04/779, të datës 13.2.2023, Listën e kandidatëve të pranuar sipas konkursit Nr. 04/752, me Nr. Prot. 04/911, të datës 13.4.2023 dhe vendimin për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave, me Nr. Prot. 1112, të datës 27.8.2020.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP-së,***
- ***Z. Arif Morina, Parashtrues i kërkesës, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kërkesës me Nr. Prot. 4172, të datës 6.9.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Me këtë vendim **I LEJOHET** udhëtimi znj. [redacted] koordinatore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Rahovecit.
2. [redacted] do të marrë pjesë në konferencë në projektin **"Ngritja e kapaciteteve në menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh - Faza 2 "** në kuadër të **JICA – Japan International Cooperation Agency**. Kjo konferencë është planifikuar të mbahet prej datës 13.6.2023 - 23.6.2023, në Japoni.
3. [redacted] ka të drejtë që të kompensohet (mëditjet dhe benificionet tjera), sipas legjislacionit në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

1. *[redacted],*
2. ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
3. ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
4. ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 641 Nr. i faq/Br.str/No.pg 157
Data/Datum/Date 29 / 5 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kërkesës me Nr. Prot. 4172, të datës 6.9.2021, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për lejimin e udhëtimit zyrtar**

1. Me këtë vendim **I LEJOHET** udhëtimi zyrtar [redacted], drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, në Komunën e Rahovecit.

2. **Z. Përparim Krasniqi** do të marrë pjesë në konferencë në projektin **"Ngritja e kapaciteteve në menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh - Faza 2 "** në kuadër të **JICA – Japan International Cooperation Agency**. Kjo konferencë është planifikuar të mbahet prej datës 13.6.2023 - 23.6.2023, në Japoni.

3. [redacted] ka të drejtë që të kompensohet (mëditjet dhe benificionet e tjera), sipas legjislacionit në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

1. [redacted]
2. *Drejtoria për Shërbime Publike,*
3. *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
4. *Arkivi.*

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 642 Nr. i faq/Br.str/No pg 58
Data/Datum/Date 29/ 5/ 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0020707/23, e dt. 16.05.2023 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katerqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

[redacted] nga Rahoveci me datë 16.05.2023 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 04.05.2023 ka lindur djal në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 644 Nr. i faq/Br.str/No.pg 158
Data/Datum/Date 29/5/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr. Br /No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr. Br/No 646 Nr. i faq/Br str/No.pg 158
Data/Datum/Date 29 / 5 / 23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**

1. **MIRATOHET** kërkesa e Sh[redacted], me Nr. Protokoli 1938, e datës 25.5.2023 për ndihmë financiare prej 600.00 € (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e manifestimit me rastin e përvjetorit të Operacionit "Shigjeta".

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

***Arsyetim***

[redacted]", si shoqatë e veteranëve, ka marrë përsipër organizimin e manifestimit me rastin e përvjetorit të Operacionit "Shigjeta".

Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë financiare të kësaj shoqate, është e arsyeshme që të përkrahet financiarisht për ruajtjen e vlerave kombëtare.

Andaj, me qëllim të përkrahjes së kësaj shoqate, është e domosdoshme ndihma financiare për organizimin e manifestimit me rastin e përvjetorit të Operacionit "Shigjeta".

Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- *[redacted]",*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivit.*

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 648 Nr. i faq/Br.str/No.pg 158
Data/Datum/Date 29/5/23

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt**

1. Me këtë vendim **lejohet** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për znj. Besarta Gashi, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtare e gjendjes civile, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit.

2. Znj. Besarta Gashi ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës, në shumën prej **30€ (tridhjetë euro)** për kurorëzimin e bërë jashtë objektit të Komunës dhe jashtë orarit të punës, më datë 14.4.2023.

3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Me kërkesë të palës, znj. Besarta Gashi, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtare e gjendjes civile, në Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit, ka marrë pjesë në kurorëzimin e shtetasve të Republikës së Kosovës e që është bërë jashtë objektit të Komunës dhe jashtë orarit të punës, me datë 14.4.2023.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh se zyrtari i lartpërmendur ka marrë pjesë në këtë kurorëzim jashtë objektit të Komunës dhe jashtë orarit të punës, është e domosdoshme që të bëhet pagesa për punën shtesë jashtë orarit të punës, të paraparë me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës

Andaj, nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Znj. Besarta Gashi,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr/Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 656 Nr. i faq/Br.str/No.pg 159
Data/Datum/Date 30 / 5 / 2023
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2018")*, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 te Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për pranimin e shërbimeve

1. **Caktohet** komisioni për pranimin e shërbimeve sipas kontratës: "Shërbimet e transmetimit të Kuvendit dhe shërbime të tjera për Komunën e Rahovecit", me Nr. identifikues: 623-22-11551-2-2-1/C449, në këtë përbërje:

    1.1. Skender Hamza, kryesues,
    1.2. Agron Thaqi, anëtar,
    1.3. Senad Mullaavda, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë pranimin e shërbimeve sipas kontratës "Shërbimet e transmetimit të Kuvendit dhe shërbime të tjera për Komunën e Rahovecit", me Nr. identifikues: 623-22-11551-2-2-1/C449.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartojë raport me shkrim për Drejtorinë për Administratë në Komunën e Rahovecit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit dhe Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria për Administratë.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Administratë,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA E RAHOVECIT – KRYETARI I KOMUNËS – RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. 657 ... faq/Br str/No.pg 159
Data 30 / 5 / 2023
RAHOVEC ... OVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 61 paragrafi 61.15 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr. A01 i datës 10.04.2019, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Lot 1 - Investime dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese, parqe, varrezave në Komunën e Rahovecit" me numër të kontratës 623-22-5495-5-2-1/C393, si në vijim:

   1.1. Z. Venhar Topalli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për shërbime publike, pranë Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2.** Z. Përparim Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me nenin 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik Nr. A01, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3026/22, i datës 21.11.2022.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i projektit,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Shërbime Publike, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. 658 Nr. 159
Data/Datum/Date 30 5 2023
RAHOVEC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe nenit 4, paragrafi 4 dhe nenit 22, të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me Nr.1427, të datës 28.4.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**

1. **MIRATOHET** kërke[redacted] me Nr. Protokolit 1971, të datës 29.5.2023 për ndihmë financiare prej 450.00€ (katërqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e shfaqjes teatrale "Tregime nga xhungla".

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyres së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

[redacted] aktor në Teatrin Dodona në Prishtinë, përfaqësues i pjesës teatrale "Tregime nga Xhungla", ka shprehur dëshirën e organizimit të shfaqjes teatrale "Tregime nga Xhungla" në Rahovec, për nder të 1 Qershorit – Ditës ndërkombëtare të fëmijëve.

Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë e shënimit të kësaj ngjarjeje të rëndësishme për fëmijët e komunës së Rahovecit, është e domosdoshme mbështetja financiare me qëllim të realizimit dhe të mbajtjes së kësaj shfaqjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**